

tutje. Fëmija tjetër e shkruan me këtë një tregim dhe ia dhuron atë të parit. (Varianti: «Listat e dëshirave» vendosen në një shportë; secili fëmijë e tër-heq verbazi një listë të tillë të fjalëve dhe shkruan në të). Zgjerim: Të luten prindërit ose dikush nga familja për një listë të tillë fjalësh dhe këtij personi t'i dhurohet me këtë një tregim. (Krahaso me këtë edhe 3, «Tregimet-fjalë dëshirash»).

5

Të shkruarit sipas fantazisë në forma të ndryshme sociale

Qëllimi

Në formë loje dhe në nivel të thjeshtë, të përkrahet gëzimi në të shkruar dhe në të treguar në gjuhën e parë si dhe të zgjohet kreativiteti. Të krijuhen situata të thjeshta për krahasime teksti dhe vlerësimi

1. Tregime me partner

kl. 2–6

30 min.



Udhëzime për literaturë:
Büchel/Isler 2006, f. 146.

a) Nga dy N punojnë bashkë (ata mund të janë edhe nga grupmosha të ndryshme). N 1 e mendon fillimin e një tregimi (një fjalë) dhe ia dikton këtë fjalë fëmijës tjetër (N 2).

b) N 2 e shkruan fjalinë e diktuar dhe mendohet se si mund të zhvillohet tregimi më tutje. Pastaj ai/ajo ia dikton fjalinë fëmijës së parë (N 1).

c) Në përfundim ia lexojnë ekipet dyshe njëri-tjetrit tregimet e tyre.
Variantet (në ± ekipet e suksesshme homogjene): Ushtrimi luhet pa fjalë: N 1 i shkruan një ose dy fjalë (= fillimi i tregimit), N 2 vazhdon me një ose dy fjalë më tutje etj.

2. Një titull - shumë tekste

kl. 3–6

30–40 min.



a) M e jep një titull atraktiv që nxit fantazinë. Shembuj: «Sikur të mund të bëja magji» / «Unë pas dhjetë viteve» / «Nëse do të isha mbret/ëreshë (ose shef/e i/e pushtetit» / «Dëshriat përvendin nga i cili vjen familja ime»

b) Secili/a N shkruan një tekst për këtë ose e modelon një fletë A 3 me tekst dhe ilustrime.

c) Ekspozitë, prezentim dhe diskutim për tekstet në grup ose në klasë.

3. Bashkërisht të shkruhet një libër aventurë

kl. 4–9

60–120 min.



Materiali:
Në dosje

a) Detyra për N (në grupe ose si projekt i klasës): mendoni bashkërisht për dy personazhe kryesore, të cilët përjetojnë lloj-lloj aventurash - në vendin tuaj të prejardhjes ose aty ku ju tash jetoni, ose kudo dikund në botë apo në gjithësi: si ju doni! Përcaktoni se si do të quhen të dy personazhet (më së miri një vajzë dhe një djalë), sa vjeç janë dhe a bëjnë diçka të veçantë (p.sh. magji, lëvizin tepër shpejt nëpër hapësirë dhe kohë ...). Bëni për të dy figurat bashkërisht një afishim (emri, mosha, hobi, veti të veçanta etj.), i cili do të jetë i vendosur në fillim të librit tuaj aventurë.

b) Pastaj shkruan secili/a N një ose më shumë eventura të cilat i përjetojnë dy personazhet kryesore.

c) Lexoni para njëri-tjetrit aventurat tuaja dhe mblidhni në një dosje.

d) Shkruani përsëri aventura të reja dhe mblidhni ato. Me kohë do të ndërtohet një libër i vërtetë aventurë!